

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, gjyqtari Mehmet Ndrecaj, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Njomëza Berisha, në lëndën penale kundër të akuzuarve M. Q. dhe B. Q. që të dy nga fshati R. të akuzuar sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Prizren, PP.nr.252/16 të datës 08.12.2016, i akuzuarit M. Q. për shkak të veprave penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të Kodit Penal të Kosovës (KPK-së), veprës penale përdorim i armës ose mjetit të trezikhëm nga neni 375 par. 2 të KPK-së dhe bashkëkryerjes së veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 nën.par.1.4 lidhur me nenin 31 të KPK-së dhe B. Q. për shkak të bashkëkryerjes së veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 nën.par.1.4 lidhur me nenin 31 të KPK-së, në shqyrtimin fillestar në prezencën, të akuzuarit M. Q. dhe mbrojtësit të tij av.B. M. nga Prizreni, më datën 23.05.2018, morri dhe shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit:

M. Q. nga i ati M. dhe e ëma G. e lindur B. i lindur më ., në fshatin R. KK Prizren, ku edhe tani banon, ka të kryer shkollën e mesme, i martuar, bukëpjekës, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me nr. personal .

B. Q. nga i ati M. i lindur më ., në fshatin R. KK Prizren ku edhe tani banon, punëtorë, i pa martuar, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me nr. personal .

JANË FAJTORË

I akuzuarit M. Q.;

I.Më datën 26.09.2016, rrëth orës 16:30, në fshatin D. KK Prizren, mban në pronësi pa leje valide një pistoletë të markës Ekoll-Firat Magnum, kalibrit 9mm me nr.1450785, në shkelje me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët

Kësot dore ka kryer veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPK-së.

II. Me datë, kohë dhe vend të njëjtë, e përdor armën-pistoletën e markës Ekoll-Firat Magnum, kalibrit 9mm me nr. 1450785, në mënyrë frikësuese ose kërcënuese ndaj M. F. dhe B. S. në atë mënyrë që pasi vëren djalin B. Q. duke u fjalosur me M. .

F... dhe B... S..., e nxjerr armën duke drejtar në drejtim të M..., F... dhe B... S... me qëllim të frikësimit.

Kësot dore ka kryer veprën penale përdorimi i armës ose mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.2 të KPK-së.

Të akuzuarit M... Q... dhe B... Q...

III. Me datë, kohë dhe vend të njëjtë, shkaktojnë lëndime të lehta trupore M..., F... dhe B... S..., duke dëmtuar përkohësisht shëndetin e tyre, në atë mënyrë që pas një mosmarrëveshjeje paraprake rreth kryerjes së punimeve nga fushë veprimitaria e tyre në shtëpinë e Sh... K... fillon një rrahje ndërmjet tyre, ashtu që të akuzuarit M... dhe B... Q... me mjete të forta dhe grushta duke goditur në pjesë të ndryshme të trupit i shkaktojë lëndime të lehta trupore me mjete mbrejtëse F... S... në fytyrë dhe në pjesën e poshtë të buzës, B... S... i shkaktojnë plagë në rëgjonin okcipital e përshkruar si plagë qarëse shqyese të indeve të buta në rëgjonin zverkor të kokës, ndërsa M... S... i shkaktojnë edem të fytyrës dhe rreth syrit të djathtë e shoqëruar me skuqje më përsë afërmim përshkruar në raporti mjekësor të ekspertit mjeko-ligjor dr. V... K... e datës 24.11.2016

Kësot dore në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale kanë kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 nën.par.1.4 lidhur me nenin 31 të KPK-së.

Andaj në kuptim të nenit 7, 41, 42, 43, 46, 49, 50, 51, 73 dhe neneve 374 par.1, 375 par.2 dhe 188 par.1 nën par.1.4 lidhur me nenin 31, të KPK, të akuzuarit:

GJ Y K O N

- **Të akuzuarin M... Q...**

-Për veprën penale si nën I. të dispozitivit të akuzës, dënim me gjobë në shumë prej 700 (shtatëqind) euro,

-Për veprën penale si nën II. të dispozitivit të akuzës, dënim me gjobë në lartësinë prej 1000 (njëmijë) euro, si dhe dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve;

-Për veprën penale si nën III. të dispozitivit të akuzës, dënim me gjobë në shumë prej 300 (treqind) euro,

Gjykata konform nenit 80 të KPK-së, të akuzuarit M... Q... i shqipton:

DËNIM UNIK ME GJOBË DHE ME BURGIM

Në shumë prej 2000 (dymijë) euro, të cilën shumë i akuzuari është i obliguar që ta paguaj në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, si dhe dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, të cilin do ta vuaj pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Në rast se i akuzuari nuk e paguan gjobën prej 2000 (dymijë) eurove, i njëjtë do të zëvendësohet me dënim me burgim, ashtu që një ditë burgim llogaritet me 20 (njëzet) euro gjobë, respektivisht 100 (njëqind) ditë burgim.

Në bazë të nenit 47 të KP, me pëlqimin e të akuzuarit, dënimini i shqiptuar me burg në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, i zëvendësohet me dënim me gjobë në shumën prej 2000 (dymijë) euro, kështu që dënimini unik për të gjitha veprat do të jetë dënimini me gjobë në shumë prej 4000 (katërmijë) euro, të cilën shumë i akuzuari do ta paguaj në afat prej 3 (tre) muajsh, me këste nga data 01-05 të çdo muaji vijues.

Nëse i akuzuari nuk dëshiron apo nuk mund të paguajë dënimin me gjobë, i njëjti i zëvendësohet me dënim me burg, ashtu që për çdo 20 € të dënimit me gjobë do t'i caktohet një ditë burg, çka do të thotë do të qëndrojnë 200 /dyqind ditë burg.

Të akuzuarit M...Q... i shqiptohet edhe dënimini plotësues, në kuptim të nenit 62 dhe 69 të KPK-së, i konfiskohet pistoleta e markës "Ecol Firat Magnum" e kalibrit 9 mm si dhe një karikator i zbrazët.

- Të akuzuarin B...Q...

- Për veprën penale si nën III të dispozitivit të akuzës, dënimini me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afatin prej 1 (një) viti, në rast se i akuzuari nuk kryen vepër tjetër penale.

Të akuzuarit obligohen që ti paguajnë shpenzimet e procedurës penale aq sa do të jenë sipas llogarisë së kësaj gjykate, për paushallin gjyqësor shumën prej nga 30 (tridhjetë) euro, (gjithsecili), për kompensimin e viktimate të krimtit shumën prej nga 30 (tridhjetë) euro, (gjithsecili), si dhe për ekspertizën mjekoligjore, në mënyrë solidare do ta paguajnë 20 (njëzetë) euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Arsyimet

Prokuroria Themelore në Prizren ka paraqitur aktakuzë PP.nr. 252/16 të datës 08.12.2016, kundër të akuzuarve M...Q... për shkak të veprave penale mbajta në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të Kodit Penal të Kosovës (KPK-së), veprës penale përdorim i armës ose mjetit të tresskëshëm nga neni 375 par. 2 të KPK-së dhe bashkëkryerjes së veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 nën.par.1.4 lidhur -

me nenin 31 të KPK-së, të akuzuarit B . Q për shkak të bashkëkryerjes së veprës penale lëndim i lehtë trupor nga nenin 188 par.1 nën.par.1.4 lidhur me nenin 31 të KPK-së, dhe kundër të akuzuarve M . S . F . S . dhe B . S . për shkak të kryerjes së veprës penale se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga nenin 188 par.1 nën.par.1.4 lidhur me nenin 31 të KPK-së.

Gjykata më datën 21.05.2018 shqyrtimin fillestar, aprovojë propozimin e të akuzuarve M . Q . dhe B . Q . që procedura penale ndaj të akuzuarve M . S . S . F . S . dhe B . S . të veçohet, për shkak se të njëjtë gjenden në punë jashtë shtetit dhe për këtë sancë kanë ardhur nga Republika e Austrisë dhe Rumanisë.

Pas kësaj është lexuar aktakuza nga prokurori. Të akuzuarit kanë deklaruar se e kanë kupltuar akuzën dhe e pranojnë fajësinë për veprën penale që i vihet në barrë dhe provueshmërinë e provave, duke shtuar se u vije keq për këto vepra që kanë kryer dhe në të ardhmen nuk do të përsërisin vepra të tilla penale, theksojnë se janë në bisedime e sipër me të akuzuarit e tjere – të dëmtuarit, që të arrijnë marrëveshje jashtëgjyqësore dhe ti rregullojnë raportet mes tyre, kërkoijnë falje edhe një herë për veprat që kanë ndodhur dhe lusin gjykatën që tu shqiptohet nga një dënim sa më i butë.

Prokurori i Shtetit ka konsideruar se janë plotësuar kushtet ligjore për pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve, dhe i propozojë gjykatës që si plotësim të dënimt të akuzuarit M . Q . ti konfiskohet pistoleta e markës "Eko firat magnum" e kalibrit 9mm si dhe një karikator e zbrazët.

Në bazë të pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarit, gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike.

Se më datën 26.09.2016, rrëth orës 16:30, në fshatin D . -KK Prizren, mban në pronësi pa leje valide një pistoletë të markës Ekoll-Firat Magnum, kalibrat 9mm me nr.1450785, në shkelje me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët. Këso dore ka kryer veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga nenin 374 par.1 të KPK-së.

Se me datë, kohë dhe vend të njejtë, e përdor armën-pistoletën e markës Ekoll-Firat Magnum, kalibrat 9mm me nr. 1450785, në mënyrë frikësuese ose kërcënuese ndaj M . S . F . dhe B . S . neë atë mënyrë që pasi vëren djalin B . S . Q . duke u fjalosur me M . F . dhe B . S . e nxjerr armën duke drejtuar në drejtim të M . S . F . dhe B . S . me qëllim të frikësimit. Këso dore ka kryer veprën penale përdorimi i armës ose mjetit të rrezikshëm nga nenin 375 par.2 të KPK-së.

Se e datë, kohë dhe vend të njejtë, shkaktojnë lëndime të lehta trupore M . S . F . dhe B . S . , duke dëmtuar përkohësisht shëndetin e tyre, në atë mënyrë që pas një mosmarrëveshjeje paraprake rrëth kryerjes së punimeve nga fushë veprimtaria e tyre në shtëpinë e Sh. K . fillon një rrahje ndërmjet tyre, ashtu që të akuzuarit M . S . dhe B . S . Q . më mjete të forta dhe grushta duke goditur në pjesë të ndryshme të trupit i shkaktojë lëndime të lehta trupore me mjete mbrejtëse F . S . S . në fytyrë dhe në pjesën e poshtë të buzës, B . S . i shkaktojnë plagë në regjionin okcipital e përshkruar si plagë-

qarëse shqyese të indeve të buta në regjionin zverkor të kokës, ndërsa M. S. i shkaktojnë edem të fytyrës dhe rrëth syrit të djathtë e shoqëruar me skujje më për së afërmë përshkruar në reporti mjekësor të ekspertit mjeko-ligjor dr. V. K. e datës 24.11.2016.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga të akuzuarit, të cilët në shqyrtimin fillestari vullnetarisht e kanë pranuar fajësinë, andaj edhe gjykata nuk ka administruar provat, gjyqtari ka konstatuar se të akuzuarit e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga të akuzuarit, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i Shtetit dhe çdo provë tjetër, dhe se aktakuza nuk përbante asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike. Gjykata nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarve formohen të gjitha elementet e qenies së veprës penale të përshkruara si në shqiptim të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarit t'i shpall fajtor dhe t'i gjykoj në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tyre. Gjatë marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata ka vlerësuar të gjitha rrëthanat lehtësuese dhe rënduese të parapara si në nenin 73 të KPK-së të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit. Prej rrëthanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrëthanat personale të akuzuarve, se në gjykim kanë pasur qëndrim korrekt, janë penduar për veprat e kryera. Kështu si rrëhana rënduese vlerësoj rrëthanat se si janë kryer veprat penale, menyra e kryerjes së veprës penale, mbajtja e armës pa leje dhe përdorimi i saj janë bërë gati fenomen në shoqërinë tonë duke rrezikuar edhe jetën e të tjerve andaj gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin me kusht dhe me gjobë, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 41 i KP-së dhe se ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcione me veprën penale të kryer dhe me rrëthanat personale të cilat i posedojnë të akuzuarit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale, është marrë konform nenit 453 par. 4 të KPP-së.

Vendimi për programin e kompensimit të viktimate të krimit është marrë në kuptim të nenit 39 parag.3 pika 1 të Ligjit me numër 05/L-036.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
P.nr.2776/16, me datë 23.05.2018

B. Profesionale
Njomëza Berisha

Gjyqtari
Mehmet Ndrecaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankesë, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të të njejtë, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.